

Përfaqësues komunash të Kosovës Juglindore nënshkruan marrëveshje me projektin LOGOS


Qeveria zvicerane financon disa projekte infrastrukturore të 6 komunave

Koordinatori i projektit LOGOS, Norbert Piljs, ka thënë se nëpërmjet këtyre projekteve do të forcohen qeverisja lokale dhe reformat në decentralizim e në përmirësim shërbimesh të qytetarëve të komunave në rajonin e Kosovës Juglindore

KOFA
Inter

IBRAHIM SEFEDINI

VITI, 5 MAJ – Drejtues komunash të Kosovës Juglindore, të Vitisë, Kllokotit, Shtërpës, Ranillukut, Novo-Bërdës, Hanit të Elezit dhe Kaçanikut, kanë nënshkruar, të enjten në Viti, marrëveshjen e bashkëpunimit me projektin LOGOS të Qeverisë zvicerane. Ai ka të bëjë me implementimin e projekteve të ndryshme të infrastrukturës në këto komuna. Komunat përfitues të projekteve nëpërmjet LOGOS-it do të realizojnë projektet e identikuara si të nevojshme për qytetarët dhe kapin shumën deri 50 mijë euro. Projekti i Qeverisë zvicerane që implementohet nga fondacioni “Intercooperation”, zyra në Prishtinë, në Komunën e Vitisë do të mbështesë projektin për fasadimin e ndërtesave publike brenda qytetit, në Komunën e Novo-Bërdës, rregullimin e parkut të Komunës dhe stacioneve të vogla të autobusëve në rrugët kryesore të qytetit dhe fshatrave, në Shtërpë e rregullimin e parkut “Rudina”, në Kllokot rregullimin e urës në rrugën magistrale Viti – Kllokot, në Kaçanik rregullimin e urës mbi Nerodime, në Han të Elezit rregullimin e ngrohjes qendrore në shkollën e Paldenicës dhe kulmet në SHF në Han të Elezit e në Ranilluk rregullimin e brigjeve të lumit që kalon në këtë komunë. Koordinatori i projektit LOGOS, Norbert Piljs, ka thënë se ky projekt që ka si qëllim forcimin e qeverisjes lokale dhe reformave të decentralizimit, në nëntë komuna të Kosovës Juglindore, në fazën e dytë në kuadër të fondit për investime



Zyrtarë të fondacionit “Intercooperation”, kanë thënë se me financimin e projekteve që janë propozuar nga vetë komunat do të përmirësohet infrastruktura dhe shërbimet e qytetarëve

kapitale do të mbështesë komunat me projekte të ndryshme infrastrukture. “Zyra zvicerane ka ndarë një fond prej 1 milion eurosh që parashihet t'i dedikohet realizmit të projekteve të ndryshme të infrastrukturës në nëntë komuna të Kosovës”, ka thënë Piljs. Merita Barileva, zyrtare në fondacionin “Intercooperation”, ka thënë se me financimin e projekteve që janë propozuar nga vetë komunat do të përmirësohet infrastruktura dhe shërbimet e qytetarëve. Kryetari i Novo-Bërdës, Bajrush Ymeri, ka theksuar se realizimi i 2 projekteve të infrastrukturës, përmes LOGOS-it, ka një rëndësi të veçantë për qytetarët e kësaj komune, pasi krahas

parkut të komunës do të rregullohen edhe vend stacionet e autobusëve për prite qytetarësh që ishte nevojë kohe. Nënkyrjetari i Vitisë, Halim Halili, është shprehur se me projektin e fasadimit të ndërtesave brenda Vitisë, qyteti do të marrë një pamje tjeter. Rufki Suma, kryetar i Hanit të Elezit, është shprehur se përmes këtij projektit në Han të Elezit do të realizohen 2 projekte për rregullimin e kulmeve në SHF “Ilaz Thaqi” në Han të Elezit dhe nxehjen qendrore ne SHF të Paldenicës. Sasha Mirkoviq, kryetar i Kllokotit, ka thënë se rregullimi i urës në rrugën Viti – Kllokot, është një projekt me rëndësi jo vetëm për qytetarët e Kllokotit, por edhe i të tjerëve.